





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK



Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e komunës për vitin 2023

Shtator, 2022

Hyrje

Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Junikut ka prezentuar projekt buxhetin për vitin 2023-2025:

Buxheti i Komunës së Junikut për vitin 2023, është **1,877,346.00 €**, ku ky buxhet është ndarë ne kategori, si:

1. Kategoria Paga dhe mëditje për vitin 2023, është : **1,170,906.00 €**
2. Kategoria Mallra dhe shërbime për vitin 2023, është **236,740.00€**
3. Kategoria e Shpenzimeve komunale për vitin 2023, është **37,700.00 €**
4. Kategoria e Subvencioneve për vitin 2023, është **52,000.00 €**
5. Kategoria e Shpenzimeve kapitale për vitin 2023, është **380,000.00€**

Krasuar me vitin 2022 kemi rritje të buxhetit prej 218,755.00 euro.

Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e vitit 2023

Kryetari i Komunës, më 10 gusht ka marrë vendim për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2023-2025

Grupi Punues për hartimin e Projekt-buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2023-2025, në këtë përbërje:

1. Arten Hamza- Zyrtari Kryesor Financiar, Kryesues
2. Florant Pepshi- Drejtoria Për Buxhet dhe Financa, Anëtar
3. Valbona Gaxherri- Drejtoria për Arsime Kultur Rini dhe Sport. Anëtare
4. Deme Ukaj- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale, Anëtar
5. Avdyl Maloku- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Anëtar
6. Ferdone Tofaj- Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis, Anëtare
7. Turim Ganiqaj- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Inspeksion, Anëtar
8. Sundim Krasniqi- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, Anëtar
9. Rustem Pepshi- Zyrtar i IT-se, Anëtar

Grupi punues ka për detyrë që të hartojë Projekt-buxhetin e Komunës së Junikut për vitin 2023-2025, të bëjë hartimin e Planit të Brendshëm komunal për mbarëvajtjen e dëgjimeve buxhetore, të bëjë përgatitjen e njoftimit për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, të caktoj personin përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit gjatë mbajtjes së dëgjimeve publike dhe të bëjë hartimin e tij në afatin ligjor që parashihet në Udhëzimin Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimeve Publik, të bëjë hartimin e raportit nga dëgjimi buxhetorë dhe ta dërgoj në Kuvendin Komunal.

Bazuar në vendimin e kryetarit, grupi punues ka mbajtur disa takime radhazi, duke bërë Planin e veprimit për dëgjimet buxhetore dhe përpilimin e kalendarit të dëgjimeve buxhetore dhe njoftimeve për publikim.

Plani i veprimit ka përfshirë organizimin e dëgjimeve publike nga ekzekutivi gjatë periudhës gusht, si dhe organizimin e dëgjimeve buxhetore nga Kuvendi Komunal përkatësisht Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë muajit shtator perkatesisht 16 shtator.

Pas vendimit nga Kryetari i komunës për formimin e grupit punues, Ekzekutivi komunal ka organizuar gjithsej 2 dëgjime publike buxhetore (këtu nuk përfshihen edhe 2 dëgjimet tjera buxhetore të organizuara me rastin e hartimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2023/2025 në Qershor të vitit 2022). Njoftimi, kalendari, Plani i veprimt dhe një dokument i detajuar mbi buxhetin janë publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut, në Platformën Qeveritare për Konsultime Publike, në rrjete sociale, janë dërguar ftesa përmes rrjeteve sociale, dhe direkt përmes thirrjeve telefonike, duke i ftuar pjesëmarrësit që të bëhen pjesë direkte në procesin e përgatitjes së buxhetit.

Publikimi është bërë në muajin gusht 2022, ashtu siç parashihet me Udhëzimin për Standardet Minimale të Konsultimeve Publike:

Njoftimi:

1. <https://kk.rksgov.net/junik/wpcontent/uploads/sites/39/2021/07/Njoftimi-per-diskutim-publik-per-buxhetin-e-vitit-2022.pdf>
2. <https://kk.rksgov.net/junik/wpcontent/uploads/sites/39/2021/07/NJOFTIMI-PER-DISKUTIMIN-E-DYTE-PER-BUXHET-2021.pdf>

Kalendari:

1. <https://kk.rksgov.net/junik/wpcontent/uploads/sites/39/2022/08/kalendari-i-Degjimeve.pdf>

Plani i Veprimt:

1. <https://kk.rksgov.net/junik/wpcontent/uploads/sites/39/2022/08/Plani-final-i-degjimeve-publike.pdf>

Dokumenti i specifikuar i buxhetit:

1. https://kk.rksgov.net/junik/wpcontent/uploads/sites/39/2022/08/1760-MFPT_DB_-_Qarkorja-Buxhetore-2023-02-per-Komuna.pdf
2. <https://kk.rksgov.net/junik/wpcontent/uploads/sites/39/2022/09/1.Buxheti-2023-Tabela-4.1-Shtator-2022-1.pdf>

Platforma Qeveritare për Konsultime Publike:

<https://konsultimet.rksgov.net/consultations.php?InstitutionID=20511&OpenPage=0&ClosedPage=0>

Dëgjimet publike buxhetore

Procesi i dëgjimeve buxhetore filloi ne muajin Gusht deri ne Shtator 2022, me gjithsej 2 dëgjime publike, në të cilet qytetarët dhe grupet e interesit patën mundësi të paraqesin kërkesat dhe sugjerimet për një buxhetim sa më gjithëpërfshirës.

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime
1. Takim i drejtpërdrejtë në Sallën e Kuvendit me te gjithë qytetarët e Komunës se Junikut	26.08.2022 60 minuta	19 pjesëmarrës 10 femra	12 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
2. Takim i drejtpërdrejtë në Sallën e Kuvendit me te gjithë qytetarët e Komunës se Junikut Organizuar nga KPF	16.9.2022 90 minuta	24 pjesëmarrës 10 femra	8 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesë

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike ne forme te diskutimeve dhe ne forme te shkruar, janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Shtojca 1 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara.

Temat e dëgjimit buxhetor	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2023	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar , pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
Projekt buxheti i vitit 2023 Dëgjim buxhetor në Sallën e Kuvendit me Qytetarët e Komunës së Junikut 26.08.2022.	1. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Lagjen Agim Ramadani.- Pjesa e mbetur	Fluri Shehu	1.I pranuar	Është përfshirë në listen e Investimeve Publike të komunës për vitet 2023/2024 në kuadër të projekteve të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Inspeksion (DSHPMI)
	1. Ndërtimi i objektit Social për Banim	Artan Krasniqi	1.I pranuar	Është përfshirë në listen e Investimeve Publike të komunës për vitet 2024/2025 në kuadër të projekteve nga DSHMS.
	1 Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në Kallavaj	Rexhep Bajram Tofaj	1. I pranuar	Është përfshirë në listen e Investimeve Publike të komunës për vitet 2023/2024 në kuadër të projekteve nga DUKM.
	1. Ndërtimi i murit mbrojtës në Lagjen Tofaj	Xhemë Tofaj	1. I pranuar	Është përfshirë në listen e Investimeve Publike të komunës për vitin 2023 në kuadër të projekteve nga DUKM.
	1. Trajtimi i ujërave të zeza 2. Trajtimi i mbeturinave 3. Kanalet e Ujitjes 4. Sigurimi i ujit të pijshëm për të gjithë qytetarët	Zenun Shala	1. I pranuar 2. I pranuar 3. I pranuar 4. I pranuar	Komuna e Junikut ka pranuar të gjitha këto kërkesa, dhe gjithsecila prej janë objektiva dhe prioritete të buxhetuara për vitin 2022 si dhe për vitet 2023/2025.

Projekt buxheti i vitit 2023 Dëgjim buxhetor në Sallën e Kuvendit me Qytetarët e Komunës së Junikut 26.08.2022	e Junikut			
	1. Rruga malore Qafa e Jasiqit deri ne lokacionin Firza 2. Pastrimi dhe Shërimi i Pyjeve me Gështënja në Junik	Tafë Tofaj	1.I pranuar 2.I pranuar	1.Është përfshirë në listen e Investimeve Publike të komunës për vitet 2023/2024 në kuadër të projekteve nga DSHPMI. 2.Është përfshirë në listen e Investimeve Publike të komunës për vitet 2024/2025 në kuadër të projekteve nga DZHE.
	1. Rregullimi i tretoarëve në Lagjen Berishë	Elona Qestaj	1. I pranuar	1.Është përfshirë në listen e Investimeve Publike të komunës për vitet 2023/2025 në kuadër të projekteve nga DSHPMI
	1. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për lagjen Bramatok, nga ura e Travës deri tek restaurant Te-Toni. 2. Rregullimi i hapësirave publike përballë stacionit të autobusëve 3. Ndërtimi i pishinave rekreative në Moronicë-Erenik. 4. Vendosja e shtyllave dhe ndriçimit publik në lagjen Bramatok 5. Ndërtimi i shtigjeve për	Ferdone Tofaj	1.I pranuar 2.I pranuar 3.I pranuar 4.I pranuar 5. I pranuar	1.Është përfshirë në listen e Investimeve Publike të komunës për vitet 2024/2025 në kuadër të projekteve nga DSHPMI 2.Është përfshirë në listen e Investimeve Publike të komunës për vitin 2024 në kuadër të projekteve nga DSHPMI 3.Komuna e Junikut është nënshkruese e marrëveshjes së bashkëfinancimit me MAPL-në për ndërtimin e bazenëve dhe parkut rekreativ në Moronicë. 4.Është përfshirë në listen e Investimeve Publike të komunës për vitin 2024 në kuadër të projekteve nga DSHPMI

	këmbësor rrethit rrugëve.			5.Do të investohet në vitin 2023 në rregullimin e disa segmenteve rrugore për të ju mundësuar lëvizje të lirë qytetarëve.
Projekt buxheti i vitit 2023 Dëgjim buxhetor në Sallën e Kuvendit me Qytetarët e Komunës së Junikut i organizuar nga KPF dhe Kuvendi Komunal 16.09.2022	1. Asfaltimi i rrugës lokale- Gjocaj	Zenun Gjocaj- Gjocaj	1. I pranuar	1.Janë duke vazhduar punimet për asfaltimin e rrugës në segmentin që lidhë Junikun me dy Ekofshatrat Gjocaj dhe Jasiq.
	1. Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në Kallavaj	Rexhep Tofaj	1.I pranuar	Është përfshirë në listen e Investimeve Publike të komunës për vitet 2023/2024 në kuadër të projekteve nga DUKM.
	1. Ndërtimi i murit mbrojtës- Rruga Isa Tofaj	Xhemë Tofaj Lulzim Gacaferi	1.I papranuar	Është planifikim për vitin 2023 në kuadër të projekteve nga DUKM.
	1. Kanali i Ujitjes në Miroc- Ledina 2. Kanali i Ujitjes Shafrane 3. Kanali rreth Lapidarit- në lagjen Çok. 4. Rregullimi i parkut të lodrave për fëmijë në lagjen Çok.	Sadri Krasniqi	1.I pranuar 2. I pranuar 3. I pranuar 4. I pranuar	1,2,3 Komuna e Junikut është përfituese e projektit për sistemin e Ujitjes (pra për ndërtimin e kanaleve të ujitjes), dhe në kuadër të këtij projekti do të përfshihen segmente të ndryshme në Komunën e Junikut. 4.Është pranuar si propozim dhe është futur në Listen e Investimeve Publike në kuadër të projekteve nga DUKM, për vitet 2023/2024.

JUNIK

Grupi Punues

